



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më .05.2024

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli: Konsultim me publikun “Politika dhe strategji për përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së përhershme në Bashkinë Elbasan.


Propozuesi: Kryetari i Këshillit Bashkiak

Qëllimi: Ky bashkëbisedim ka për qëllim të përfshijë grupet shoqërore në vendimarrje lidhur me një pikë të rendit të ditës së mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak Elbasan. Këshilli Bashkiak do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sygjerimet e qytetarëve mbi miratimin e disa vendimeve që kërkojnë konsultim me bashkësinë bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Neni 18 dhe Neni 54.

Kalendari:

- Bashkia Elbasan, Salla e mbledhjeve (Kati III), datë 22.05.2024 ora 12:00.

Qëllimi i konsultimit publik	Konsultimi publik synon të marrë mendimet dhe sygjerimet e qytetarëve lidhur me vendimarrjen e Këshillit Bashkiak Elbasan.
Përshkrimi i çështjes	Politika dhe strategji për përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së përhershme në Bashkinë Elbasan.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve	Kontaktet ku do të dërgohen rekomandimet janë: Sektori i Arsimit Parashkollor: Evis Stafa, e-mail: evis.stafa@elbasani.gov.al
Dokumentacioni në lidhje me çështjen që konsultohet	Bashkangjitur këtij njoftimi gjeni relacionin dhe planin që do të shqyrtohet në konsultimin publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Elbasan më 14.05.2024

RELACION

**MBI PLANIN STRATEGJIK: “POLITIKA DHE STRATEGJI PËR PËRMIRËSIMIN
E ARSIMIT PARASHKOLLOR DHE FËMIJËRISË SË HERSHME
NË BASHKINË E ELBASANIT”.**

Në shoqëritë moderne, arsimit parashkollor dhe periudha e fëmijërisë së hershme shërbejnë si themelet e aftësive intelektuale, emocionale dhe sociale të fëmijëve. Politikat dhe strategjitë për përmirësimin e këtyre segmenteve të arsimit, janë thelbësore për të siguruar një platformë të fortë për zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Sigurimi i cilësisë në arsim lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me fazën paraprake të përgatitjes së fëmijës, e cila mundësohet përmes kujdesit dhe edukimit të shtuar që në fëmijërinë e hershme dhe më pas në arsimin parashkollor.

Për këtë arsye, bashkia e Elbasanit kërkon të përqendrojë vëmendjen e saj në këto dy fasha edukimi, me qëllim që të formojë dhe edukojë breza të aftë dhe qytetarë të denjë për t'u integruar suksesshëm në ciklet e tjera të edukimit. Duke qenë se vitet e para të jetës kanë një rëndësi të veçantë për formimin e shprehive dhe zhvillimin e kapacitetit formësues, ne kemi synimin të forcojmë politikat vendore, me qëllim përmirësimin e shërbimit për fëmijërinë e hershme dhe arsimin parashkollor në institucionet tona.

Në fomën e një drafti, ju paraqesim këtë material i cili i përgjigjet hartimit të planit strategjik të bashkisë së Elbasanit për përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme. Me Urdhrin nr.269 datë 23.02.2024 “ Për ngritjen e grupit të punës që do të hartojë Politikën dhe Strategjinë për Përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme” nga Kryetari i Bashkisë, një grup pune i përbërë nga ekspertë që punojnë në fushën e arsimit, por jo vetëm, ka konceptuar për afro tre muaj këtë material i cili vjen aktualisht në formën e një drafti për konsultim public, si një hap i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të siguruar një strategji efektive dhe gjithëpërfshirëse për përmirësimin e këtij shërbimi.

Bashkia e Elbasanit synon të planifikojë strategjitë dhe politikat vendore për përmirësimin e standarteve të ofruara në çerdhet dhe kopshtet tona, duke identifikuar fillimisht nevojat dhe kërkesat për zgjerimin e ofrimit të këtij cikli arsimor, nisur nga elemente të veçantë të studimit që do të realizohen në vijim.

Vizioni i politikave arsimore të bashkisë së Elbasanit siguron parimet e barazisë dhe diversitetit, që mundëson formim cilësor të fëmijëve në edukim, duke kontribuar të arrijë kushte më të mira për mirërritjen dhe mirëqenien e fëmijëve në moshë të hershme, si dhe cilësi në ofrimin e shërbimit arsimor për fëmijët e arsimit parashkollor përmes zgjerimit të rrezes së këtij shërbimi në qytet.

Qëllimi i strategjisë dhe hartimi i politikave vendore lidhet me fuqizimin e aspekteve administruese të bashkisë së Elbasanit për të përforcuar përmirësimin e kushteve që ofrohen për zhvillimin e kujdesit ndaj fëmijërisë së hershme dhe edukimin e fëmijëve në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së edukimit në këto institucione.

Drafti mbi plan-strategjinë për përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme në bashkinë e Elbasanit, i cili do të gjejë zbatim për periudhën 2024-2027, i përgjigjet këtij synimi:

“Identifikimi i nevojave për përmirësim dhe ndërhyrje në veprimtarinë që ushtrojnë institucionet e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme, duke u fokusuar në sigurimin dhe përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve menaxhuese të këtyre institucioneve, nëpërmjet hartimit të një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse, e cila do të krijojë bazat për zhvillim të qëndrueshëm për vitet në vijim, në seksionin e arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme.”

Në fokusin e këtij plani janë:

- Hartimi i politikave për sigurimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në këto institucione.
- Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës, logjistikës dhe cilësisë në institucionet e arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme.
- Krijimi i institucioneve të reja për arsimin parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme.
- Rikonceptimi i organizimit të disa grupeve të arsimit parashkollor.
- Përmirësimi i proceseve të menaxhimit sectorial.
- Përmirësimi i procese të bashkëpunimit ndërsektorial.
- Zhvillimi i politikave të aspektit mbështetës.

Sfida për të përmirësuar cilësinë e shërbimit në arsimin parashkollor dhe fëmijërinë e hershme është një detyrë e përbashkët për të gjithë. Duke nisur nga politikat dhe strategjitë e duhura, ne jo vetëm që investojmë në të ardhmen e fëmijëve tanë, por ndërtojmë edhe themelet e një shoqërie të qëndrueshme dhe të zhvilluar për të gjithë.

Duke ju falenderuar,

KRYETARI
Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Asim Sula



BASHKIA ELBASAN

PLAN STRATEGJIK

(DRAFT)

**“Politika dhe strategji për përmirësimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë
së hershme në bashkinë e Elbasanit”**

Elbasan, shkurt 2024

Ky material (draft) u punua dhe u konsultua përgjatë një periudhe 3-mujore përmes diktutimeve konstruktive ndërmjet anëtarëve të grupit të punës.

Grupi i punës:

- 1. Asim Sula (zëvendëskryetar) – Kryetar i grupit të punës**
- 2. Jonida Cungu (këshilltare) – anëtar**
- 3. Gentian Dyrmyshi (drejtor i DPSHO) – anëtar**
- 4. Dorina Roseni (drejtore e SHAP) – anëtar**
- 5. Evis Stafa (përgjegjëse e SAP) – anëtar**
- 6. Ermira Sinanaj (drejtore e kopshtit nr.2) – anëtar**
- 7. Valbona Lala (drejtore e kopshtit nr.9) – anëtare**
- 8. Elda Tabaku (drejtore e kopshtit nr.11) – anëtare**
- 9. Mimoza Arapi (përgjegjëse e çerdheve nr.1 &3) - anëtare**

shkurt – maj 2024

Përmbajtja

- 1. Hyrje**
- 2. Qëllimi (i politikave dhe studimit)**
- 3. Objektivat**
- 4. Vizioni**
- 5. Metodologjia**
- 6. Situata aktuale. Konteksti**
- 7. Arsimi në fokusin e bashkisë së Elbasanit**
- 8. Nevoja për ndërhyrje në bazë të situatës aktuale**
- 9. Politikat**
- 10. Politikat e zhvillimit**
- 11. Plan për zbatimin e politikave dhe strategjisë vendore**
- 12. Analiza SWOT**

Mesazhi i kryetarit të bashkisë së Elbasanit

Në jetën e një fëmije çdo moment është i vlefshëm. Ne i vlerësojmë vitet e para të jetës si periudhën më të rëndësishme të individit për t'u zhvilluar fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht. Bashkia e Elbasanit është e angazhuar për hartimin e politikave lehtësuese, duke u mbështetur jo vetëm në politikat e përgjithshme kombëtare të arsimit, por edhe në kushtet, veçoritë demografike, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën si dhe parimeve të barazisë e diversitetit.

Si kryetar i bashkisë së qytetit të Elbasanit, si njohës i të drejtave themelore të fëmijëve dhe njeriut, si prind dhe qytetar angazhohemi për të bërë të mundur një fëmijëri të përkujdesur për të gjithë fëmijët e qytetit. Arsimi ka një vend të posaçëm në agjendën politike të këtij mandati qeverisës lokal, duke dashur të jemi në koherencë me agjendën politike të Shqipërisë për arsimin dhe duke kërkuar të përmirësojmë më tej këtë shërbim, me qëllim përmbushjen e kriterëve për antarësim dhe përparim të mëtejshëm në procesin e integritit evropian.

Çdo ditë e këtij mandati qeverisës do të shërbejë për të mbështetur dhe për t'i dhënë përparësi politikave, projekteve dhe angazhimeve të shumta në fushë të arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme, me qëllim që cilësia e shërbimit arsimor që ofrohet, të jetë në nivelet më të mira. Edukimi parashkollor konsiderohet nga ne si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e fëmijëve, duke qenë themeli i fillimit të jetës, pavarësisht aftësive që ka çdo fëmijë.

Për ju, për çdo fëmijë të këtij qyteti!

Gledian Llatja

1. Hyrje

Zhvillimi i fëmijërisë së hershme dhe arsimit parashkollor përfshin mirërritjen, mirëqenien, kujdesin dhe edukimin e fëmijëve nga mosha 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç. Ky nivel arsimor ofrohet nëpërmjet institucioneve të veçanta (çerdhe e kopshte), të cilat janë nën juridiksionin e bashkisë së Elbasanit për t'u administruar, rregulluar, kujdesur dhe përmirësuar. Kuadri ligjor shqiptar (VKM. Nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020”) mundëson përparim në drejtim të zbatimit të funksioneve të përbashkëta në sistemin e arsimit, duke fuqizuar bashkëpunimin edhe me institucionet përgjegjëse për arsimin. Politikat që priten të ndiqen dhe të zbatohen janë në përputhje me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit në Shqipëri (*Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2021-2026*), por edhe në rajon e Europë, ku synojmë të huazojmë përvojat më të mira në funksion të përmirësimit të cilësisë së arsimit në rajonin e Elbasanit. Ligji 69/2018 (i ndryshuar) “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i kalon pushtetit lokal nën juridiksionin e saj aspektet administruese, menaxhuese dhe rregulluese, që lidhen ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor. Në fokus të këtij kuadri mbështetës ligjor, bashkia e Elbasanit harton planin e politikave dhe strategjive (i detajuar në formatin e një studimi) për përmirësimin e shërbimit arsimor parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme, që ofrohet në juridiksionin e kësaj bashkie.

Sigurimi i cilësisë në arsim lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me fazën paraprake të përgatitjes së fëmijës, që mundësohet përmes kujdesit dhe edukimit të shtuar që në fëmijërinë e hershme e më pas në arsimin parashkollor. Për këtë arsye, bashkia e Elbasanit kërkon të përqendrojë vëmendjen e saj në këto dy fasha edukimi, me qëllim që të formojë dhe edukojë breza të aftë dhe qytetarë të denjë për t'u integruar suksesshëm në ciklet e tjera të edukimit. Duke qenë se vitet e para të jetës kanë një rëndësi të veçantë për formimin e shprehive dhe zhvillimin e kapacitetit formësues, ne kemi synimin të forcojmë politikat vendore, me qëllim përmirësimin e shërbimit për fëmijërinë e hershme dhe arsimin parashkollor në institucionet tona.

Politikat e UNICEF sugjerojnë se fëmijëria e hershme ofron një dritare kritike të mundësive për të formësuar trajektoren e zhvillimit holistik të një fëmije dhe për të ndërtuar një themel për të ardhmen e tyre, me qëllim që fëmijët të arrijnë potencialin e tyre të plotë, siç është e drejta e tyre

njerëzore. Ata kanë nevojë për kujdes shëndetësor, ushqim, mbrojtje nga dëmtimet dhe një ndjenjë sigurie, mundësi për mësim të hershëm dhe kujdes të përgjegjshëm, si: të folurit, të kënduarit dhe të luajturit me prindërit dhe kujdestarët, që i duan ata. E gjithë kjo është e nevojshme për të ushqyer trurin në zhvillim dhe për të ushqyer trupat në rritje. Rëndësia e edukimit në fëmijërinë e hershme është një nga politikat prioritare të bashkisë së Elbasanit, e cila gjen zbatim në planifikimet strategjike dhe buxhetin e hartuar nga ky institucion.

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, ku Shqipëria u bë pjesë në vitin 2015 së bashku edhe me 192 shtete të tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara, ka një nga objektivat kryesorë:

-Ofrim i të paktën 1 vit arsimit parashkollor falas dhe të detyrueshëm, gjithëpërfshirje dhe eliminim i disparitetit gjinor.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 është strategji ndërsektoriale, që synon mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve. Në kuadër të fushës strategjike është dhe objektivi:

-Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (0 – 6 vjeç).

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020 ka për qëllim:

-të përmirësojë cilësinë e arsimit gjithëpërfshirës dhe të forcojë kapacitetet e mësimdhënies për fëmijët me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara, që përfshijnë futjen e komisioneve multidisiplinore të arsimit, futjen e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara që studiojnë në shkolla të zakonshme dhe përgatitjen e materialit të ri didaktik.

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 ka për synim:

-heqjen e pengesave me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës nëpërmjet integritit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor.

Parashtrimi i këtyre politikave në *Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026* e vendos pushtetin lokal (në këtë rast bashkinë e Elbasanit) përpara hartimit të politikave dhe strategjive afatgjata, të cilat do të jenë në funksion të mbështetjes së punës për të siguruar kushte dhe kujdes në kuadër të zhvillimit holistik të fëmijëve në moshë të hershme. Për të realizuar mbarëvajtjen e

politikave kombëtare, bashkia e Elbasanit synon të planifikojë strategjitë dhe politikat vendore për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrohet për arsimin parashkollor dhe fëmijërinë e hershme, duke identifikuar fillimisht nevojat dhe kërkesat për zgjerimin e ofrimit të këtij cikli arsimor, nisur nga elemente të veçantë të studimit që do të realizohen në vijim. Arsimi parashkollor dhe kujdesi ndaj fëmijërisë së hershme mbetet një nga prioritetet e bashkisë së Elbasanit dhe strukturave përgjegjëse të saj, e cila do të punojë gjatë mandatit 2023-2027 për realizimin e plotë të qëllimeve.

2. Qëllimet:

Qëllimi i strategjisë dhe hartimi i politikave vendore lidhet me fuqizimin e aspekteve administruese të bashkisë së Elbasanit për të përforcuar përmirësimin e kushteve që ofrohen për zhvillimin e kujdesit ndaj fëmijërisë së hershme dhe edukimin e fëmijëve në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së edukimit në këto institucione.

Qëllimi i planifikimit: Ky draft plani-strategjik ka për qëllim të identifikojë nevojat për përmirësim dhe ndërhyrje në veprimtarinë që ushtrojnë institucionet e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme, duke u fokusuar në sigurimin dhe përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve menaxhuese të këtyre institucioneve, nëpërmjet hartimit të një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse, e cila do të krijojë bazat për zhvillim të qëndrueshëm për vitet në vijim në seksionin e arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme.

3. Objektivat

Politikat vendore dhe strategjitë planifikuese do të kenë një rol shumë të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve përmes këtyre objektive:

Objektiva të përgjithshme

-Të përmirësojë cilësinë e shërbimit në arsimin parashkollor dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, duke krijuar kushtet e përshtatshme fizike dhe arsimore përmes menaxhimit të kurrikulës dhe kapaciteteve njerëzore.

-Të identifikojë nevojat për zhvillim dhe të planifikojë veprimtaritë e nevojshme për përmirësim, duke fuqizuar rrezën e mbulimit të shërbimit për fushën e arsimit në zonat e bashkisë, ku nuk ka institucione të arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme.

-Të planifikojë hapjen, rregullimin dhe rehabilitimin e institucioneve të arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme, duke siguruar ofrimin e një infrastrukture bashkëkohore për të plotësuar nevojat dhe interesat e fëmijëve të bashkisë së Elbasanit.

-Të bashkëpunojë me institucionet e pushtetit qendror për realizimin e politikave të hartuara mbi arsimin, duke angazhuar kapacitetet institucionale lokale për menaxhimin dhe forcimin e burimeve njerëzore.

-Të zhvillojë në nivel lokal kornizën konceptuese të arsimit në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve sipas parimit të barazisë dhe të bëjë të mundur aksesimin e institucioneve arsimore për të gjithë fëmijët e qytetit të Elbasanit.

Objektiva specifike

-Të riorganizojë infrastrukturën e institucioneve të arsimit parashkollor nëpërmjet përqendrimit të grupeve të kopshtetvve në varësi të shkollave të arsimit parauniversitar drejt organizimit me drejtori më vete dhe të mundësojë forcimin e organeve kolegiale, me qëllim demokratizimin e vendimmarrjeve në kopshte e çerdhe.

-Të hartojë databazën efektive për menaxhimin me efikasitet dhe cilësi të burimeve njerëzore, me qëllim vlerësimin e drejtë të performancës së çdo punonjësi, përmes hartimit, zbatimit dhe monitorimit të planit të përmirësimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucioneve.

-Të mbështesë punonjësit e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme përmes zhvillimit profesional, duke i siguruar trajnime të ndryshme me fokus arritjen e standardeve profesionale të mësuesit të arsimit parashkollor.

-Të përmirësohet shërbimi në institucionet e arsimit parashkollor, duke bashkëpunuar me Qendrën Kulturore të Fëmijëve për evidentimin e talenteve që në moshë të hershme.

4. Vizioni

Vizioni i politikave arsimore të bashkisë së Elbasanit siguron parimet e barazisë dhe diversitetit, që mundëson formim cilësor të fëmijëve në edukim, duke kontribuar të arrijë kushte më të mira për mirërritjen dhe mirëqenien e fëmijëve në moshë të hershme, si dhe cilësi në ofrimin e

shërbimit arsimor për fëmijët e arsimit parashkollor përmes zgjerimit të rrezes së këtij shërbimi në qytet.

5. Metodologjia

Ky studim është bazuar mbi të dhënat e siguruara nga dokumentacioni i bashkisë së Elbasanit, të cilat janë të përditësuara me situatën aktuale dhe mbledhjes së informacionit në terren përmes intervistave me qytetarë të Elbasanit. Janë shfrytëzuar për mbledhjen e informacionit të dhënat e marra nga dokumentet e politikave kombëtare, dokumentet e politikave rajonale dhe atyre lokale, me qëllim që të kemi një bashkërendim të strategjive dhe politikave në nivel planifikimi kombëtar e lokal.

Drafti i planit startegjik për arsimin parashkollor dhe fëmijërinë e hershme është përpjekur të ndërlihtë në një kuadër të integruar analizën e thelluar të gjendjes ekzistuese, parashikimin e nevojave aktuale dhe të ardhshme të bashkisë së Elbasanit, nevojat për ndërhyrje dhe koordinimin e ideve të studimit me politikat kombëtare dhe lokale. Planifikimi i politikave dhe startegjive synon të përmirësojë shërbimin e arsimit parashkollor në bashkinë e Elbasanit, duke u zbatuar në të gjitha kopshtet dhe çerdhet që ka nën juridikson.

6. Situata aktuale/ Konteksti

Reforma territoriale dhe miratimi i ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i njeh të drejtën pushtetit local, konkretisht bashkisë së Elbasanit për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe. Në bashki funksionon Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor që nga viti 2016, e cila ka në përbërjen e saj punonjës nga fusha e arsimit.

Aktualisht, bashkia e Elbasanit ka në funksionalitet 3 çerdhe dhe 106 kopshte (*si institucion arsimor parashkollor më vete dhe/ose grupe brenda/jashtë godinave¹ të institucioneve arsimore parauniversitare*).

¹ Sepse kemi edhe godina jashtë mjediseve të shkollave që janë në inventarin e bashkisë ose janë marrë me qera nga bashkia për kopshte dhe shkolla.

Qyteti ka një popullatë rreth 215876 banorë, ku 13.000 prej tyre janë nxënës që frekuentojnë arsimin parauniversitar. Sipas të dhënave statistikore të bashkisë Elbasan, lidhur me numrin e fëmijëve që kanë frekuentuar çerdhet dhe kopshtet deri në vitin 2023 kemi:

1. Numri i fëmijëve që kanë frekuentuar çerdhet

Viti shkollor	Nr. total i fëmijëve	F	M	Egjiptian	Rom
2022-2023	375	173	202	9	4

2. Numri i fëmijëve që kanë frekuentuar kopshtet

Viti shkollor	Nr. total i fëmijëve	F	M	Egjiptian	Rom
2022-2023	3344	1620	1724	242	73

3. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar që kanë frekuentuar kopshtet


Viti shkollor	Nr. total i fëmijëve me AK	Mësues ndihmës
2022-2023	23	8

4. Shpërndarja e kopshteve dhe çerdheve në bashkinë e Elbasanit

Në zonën urbane të bashkisë së Elbasanit ndodhen rreth 37 objekte arsimore, ku ofrohet arsim parashkollor, përfshirë këtu kopshtet me drejtori dhe anekset në varësi të tyre si dhe klasat përgatitore në shkollat e arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të bashkuar.

Ndërsa në njësitë administrative ose në zonën rurale ndodhen rreth 71 objekte arsimore, ku ofrohet arsim parashkollor përfshirë këtu grupet parashkollore në mjediset e shkollave të arsimit bazë që i kanë në organikë ose në godina jashtë mjediseve të shkollave, qofshin këto në inventarin e bashkisë ose me qira nga bashkia.

Tabelë. 1



Tabelë. 2

Njësia administrative	Institucione të arsimit parashkollor ²	Institucione të fëmijërisë së hershme	Institucione me drejtori më vete	Nr. i fëmijëve për kopsht	Grupe në varësi të shkollave	Shkollat ku gjenden grupet	Nr. i fëmijëve për grup <i>Mesatarisht</i>
Lagjja nr.1	7 ³	1	4	682 ⁴	3	“Luigj Gurakuqi” “Naim Frashëri”	29.7 ⁵
Lagjja nr.2	10	1	3	348	2	“Ali Agjah” “Onufri”	20.5
Lagjja nr.3	7		3	320	2	“Jorgji Dilo” “Sul Misiri”	21.3
Lagjja nr.4	5	1	3	322	3	“Bardhyl Popa” “Fejzulla Guranjaku”	21.5

² Nëse i llogarisim si objekte arsimore që ofrojnë arsim parashkollor, këtu janë përfshirë:

- Kopshtet me drejtori më vete
- Grupet e kopshteve në varësi të kopshteve drejtori, brenda ose jashtë mjediseve të shkollave (anekse)
- Klasat përgatitore në varësi të drejtorive të shkollave
- Kopshtet në varësi të drejtorive të shkollave në njësitë administrative

³ Psh, këtu janë përfshirë:

- 3 kopshte me ushqim / Kopshti 5-7-12 me 4 grupe secila dhe 12 grupe në total
- 1 kopsht pa ushqim / Kopshti 11, godina qendër me 4 grupe
- 2 shkolla me klasa përgatitore / 2 grupe tek shkolla “Luigj Gurakuqi” dhe 1 grup tek shkolla “Naim Frashëri”
- 1 aneks / pranë shkollës “Abdyl Paralloi” me 3 grupe dhe shkollës “Naim Frashëri” me 1 grup që varen nga Kopshti 11

⁴ Këtu është llogaritur numri total, nëse duhet mesatarisht për kopsht është: $682/7=97.4$ fëmijë/kopsht

⁵ Këtu është llogaritur numri total i fëmijëve / numrin e grupeve në këto 7 objekte arsimore: $682/23=29.65 =29.7$ f/g

Lagjja nr.5	3		2	226		“Fadil Gurmani”	22.6
Lagjja nr.6	5		1	211	1	“Sul Domi”	17.6
Bradashesh	9	0	0	241	16	“Alush Lleshanaku” “Myrteza Gjoni” “Florenc Balla”	15.1
Funar	2	0	0	26	2	“Ibrahim Ceka” “Isuf Deliu”	13
Gracen	4	0	0	56	4	“Gjormë”	14
Gjinar	5	0	0	46	5	“26 Shtatori” “Lleshan”	9.2
Gjergjan	5	0	0	89	6	“Xhemal Jance” “Ali Sollaku”	14.8
Lab-Fushë	8	0	0	139	9	“Sali N Ballkoci” “Sulejman Rranci” “Abdulla Keta” “Musa Bica”	15.4
Labinot-Mal	8	0	0	116	9	“11 Dëshmorët” “Ibrahim Bozhiqi” “Gur I zi” “Ramë Karagiozi” “Sericë”	12.9
Papër	9	0	1	115	4	“Fiqir Baltëza” “Seit Pepa” “Pajun”	12.8
Shirgjan	6	0	0	123	9	“Kuqan” “Ismail Kasa”	13.7
Shushicë	7	0	0	195	12	“Shushice” “Shelcan” “Fushë Buall” “Hajdaran” “Mizë”	16.3
Tregan	7	0	0	80	7	“Jonuz Carciu” “Shilbater”	11.4
Zavalinë	1	0	0	9	1	“Kodhek Dedja”	9

Tabelë. 3


Arsimi parashkollor në Elbasan (jo në varësi të drejtorive të shkollave)

NR	FËMIJE GJITHSEJ		NR. I GRUPEVE		EDUKATORE GJITHSEJ		EDUKATORE		DREJTUESE GJITHSEJ
	ME USHQIM	PA USHQIM	ME USHQIM	PA USHQIM	ME USHQIM	PA USHQIM	AL	AM	
1	959	744	31	42	63	55	118		17


Në bashkinë e Elbasanit kryejnë funksionin e tyre 17 kopshte me drejtori, nga të cilat: 8 prej tyre janë kopshte me ditëngrënie, ndërsa 9 të tjerat janë kopshte pa ditëngrënie; 16 kopshte janë në zonën urbane të bashkisë, ndërsa 1 kopsht ndodhet në zonën rurale.

Në çdo rajon ndodhet mesatarisht 1 kopsht me ushqim dhe 1 kopsht pa ushqim.

Tabelë.4




Tabelë. 5



Në zonën rurale të bashkisë së Elbasanit numri më i madh i banorëve është në Bradashesh, ku është dhe numri më i lartë i kopshteve në njësi, me 4 shkolla drejtori dhe rreth 9 kopshte në varësi me 16 klasa parashkollore.

Tabelë. 6



Arsimi parashkollor në Elbasan (në varësi të drejtorive të shkollave)

Tabelë. 7

NR	FËMIJE GJITHSEJ		NR. I GRUPEVE		EDUKATORE GJITHSEJ		EDUKATORE		DREJTUESE GJITHSEJ
	ME USHQIM	PA USHQIM	ME USHQIM	PA USHQIM	ME USHQIM	PA USHQIM	AL	AM	
1	0	1641	0	108	0	97	97		

65% e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuara në zonën urbane të bashkisë së Elbasanit ose më saktë, 11 shkolla të arsimit bazë dhe 2 shkolla të mesme të bashkuara kanë në strukturën e tyre arsim parashkollor, pasi kanë klasa përgatitore. Situata e klasave përgatitore pranë institucioneve arsimore të ciklit 9-vjeçar ose të mesëm të bashkuar në juridiksionin e Elbasanit është e trashëguar prej vitesh.

Tabelë. 8

	Institucioni arsimor	Numri i klasave
1	“Ali Agjah”	1 <i>klasë përgatitore</i>
2	“Bardhul Popa”	2 <i>klasa përgatitore</i>
3	“Fadil Gurmani”	1 <i>klasë përgatitore</i>
4	“Fejzullah Guranjaku”	1 <i>klasë përgatitore</i>
5	“Hamit Mullisi”	1 <i>klasë përgatitore</i>
6	“Jorgji Dilo”	1 <i>klasë përgatitore</i>
7	“Naim Frashëri”	1 <i>klasë përgatitore</i>
8	“Qemal Haxhihasani”	1 <i>klasë përgatitore</i>
9	“Sul Misiri”	1 <i>klasë përgatitore</i>
10	“Onufri”	1 <i>klasë përgatitore</i>
11	“Luigj Gurakuqi”	2 <i>klasa përgatitore</i>
12	“Alush Lleshanaku”	1 <i>klasë përgatitore</i>
13	“Sulejman Rranci”	1 <i>klasë përgatitore</i>

33% e shkollave 9-vjeçare kanë në mjediset e tyre grupe parashkollor, të cilat nuk i kanë në organikën e tyre pasi janë në varësi dhe statistikë të kopshteve me drejtori sipas tabelës së mëposhtme.

Tabelë. 9

Nr	Shkolla ku ndodhen	Kopshti që i ka në varësi	Nr i klasave
1	“Jeronim de Rada”	Kopshti 6	1
2	“Ptoleme Xhuvani”	Kopshti 4	2
3	“Naim Frashëri”	Kopshti 11	1
4	“Sulë Domi”	Kopshti 17	2
5	“Abdyl Paralloi”	Kopshti 11	4
6	“Xhaferr Hakani”	Kopshti 15	1

94% ose të gjitha shkollat “qendër” në njësitë administrative (me përjashtim të dy shkollave të mesme të veçanta) kanë në organikën e tyre kopshte.


Tabelë.10

Nr.	Njësia Administrative	Arsimi	Shkolla	Nr i klasave/grupeve
1	Bradashesh	9-vjeçare	Balëz (Myrteza Gjoni)	3
2	Bradashesh	9-vjeçare	Bradashesh (Alush Lleshanaku)	5

3	Funar	Mes. e bashkuar	Funar (Ibrahim Çeka)	2
4	Shushicë	9-vjeçare	Fushëbull	1
5	Gjergjan	9-vjeçare	Gjergjan (Xhemal Jança)	4
6	Gjinar	9-vjeçare	Gjinar (26 Shtatori)	3
7	Gracen	9-vjeçare	Gjormë	4
8	Labinot Fushë	9-vjeçare	Godolesh (A.Keta)	2
9	Labinot Fushë	9-vjeçare	Griqan Poshte (Musa Bica)	2
10	Labinot Mal	9-vjeçare	Gur i Zi	2
11	Shushicë	9-vjeçare	Hajdaran (Riza Salla)	2
12	Shirgjan	9-vjeçare	Jagodinë (Ismail Kasa)	2
13	Bradashesh	9-vjeçare	Katund i Ri (Europa)	2
14	Shirgjan	9-vjeçare	Kuqan	7
15	Bradashesh	9-vjeçare	Kusarth (Florenc Balla)	3
16	Labinot Fushë	Mes. e bashkuar	Labinot Fushë (Sali N.Ballkoci)	2
17	Labinot Mal	Mes. e bashkuar	Labinot Katund (11 Dëshmorët)	2
18	Gjinar	9-vjeçare	Lleshan	2
19	Labinot Fushë	9-vjeçare	Mengël (Sulejman Rranci)	3
20	Shushicë	9 -vjeçare	Mlizë	2
21	Funar	9-vjeçare	Mollagjesh (Isuf Deliu)	1
22	Papër	9-vjeçare	Pajun	1
23	Papër	Mes. e bashkuar	Papër (Fiqiri Baltëza)	1
24	Labinot Mal	Mes. e bashkuar	Qafë (Ibrahim Bozhiqi)	1
25	Labinot Mal	9-vjeçare	Qerret	3
26	Labinot Mal	9-vjeçare	Sericë	1
27	Shushicë	9-vjeçare	Shelcan (Jonuz Topuzi)	2
28	Tregan	9-vjeçare	Shilbatër	3
29	Shushicë	9-vjeçare	Shushicë	4
30	Gjergjan	9-vjeçare	Thanë (Ali Sollaku)	2
31	Tregan	9-vjeçare	Tregan (Jonuz Çarçiu)	4
32	Papër	9-vjeçare	Vidhas (Seit Pepa)	2
33	Labinot Fushë	9-vjeçare	Xibrakë (R.Bala)	1
34	Zavalinë	Mes. e bashkuar	Zavalinë	1

Pjesa më e madhe e kopshteve, rreth 84% e tyre, ndodhen brenda mjediseve të shkollave, ndërsa një pjesë e vogël ose 16% ndodhen në godina të veçanta jashtë ndërtesave të shkollave, ku 30% janë në mjedise me qira nga bashkia.

Tabelë.11



Bashkia Elbasan ka një numër të konsiderueshëm familjesh që trajtohen me ndihmë ekonomike, afro 57346 familje (207442 individë), ku 399 familje janë të pakicave etnike rome. Lagjet me densitet më të madh popullsie janë: Lagjja nr. 3 (28361 banorë), Lagjja nr. 1 (23445 banorë), Lagjja nr. 2 (23299 banorë), Lagjja nr. 4 (22214 banorë), Lagjja nr. 6 (21689 banorë), Lagjja nr. 5 (13820 banorë), ndërsa njësitë e tjera administrative vijojnë me numër më të vogël banorësh.

Rreth 116 fëmijë ose 3.46% e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet i përkasin familjeve në nevojë apo që trajtohen me ndihmë ekonomike. Vetëm 10% e tyre kanë frekuentuar kopshtet me ushqim, ku 41% përfitojnë ushqim pa pagesë nga bashkia si pjesë e një projekti me organizatën “Save the Children”.

Rreth 7% e fëmijëve 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike janë të komunitetit rom & egjiptianë. Pjesa më e madhe fëmijëve të komunitetit egjiptianë, rreth 90% e tyre janë në zonën urbane të bashkisë së Elbasanit, ndërsa pjesa tjetër në zonën rurale. Fëmijët e komunitetit rom janë të gjithë në zonën urbane. Këtë vit shkollor kopshtet publike i kanë frekuentuar rreth 221 fëmijë të komunitetit egjiptianë dhe 76 fëmijë të komunitetit rom. 18% e tyre ose 40 fëmijë kanë frekuentuar kopshtet me ushqim, ku 60% e tyre përfitojnë ushqim pa pagesë nga bashkia ndërsa pjesa tjetër kanë frekuentuar ato pa ushqim.

Densiteti fëmijëve për çdo kopsht është 31.5 fëmijë.

Densiteti i fëmijëve për çdo çerdhe është mesatarisht 125 fëmijë/çerdhe.

Bashkia Elbasan nuk aplikon taksë për arsimin, gjë që krijon mungesë në mledhjen e të ardhurave për këtë qëllim. Për të përmbushur zbatimin e politikave në fushë të arsimit përdoren të ardhura nga buxheti i bashkisë, si dhe nga bashkëpunimi me pushtetin qendror dhe me organizatat jofitimprurëse.

7. Arsimi në fokusin e bashkisë Elbasan

Numri më i madh i institucioneve të arsimit parashkollor gjendet në qytetin e Elbasanit, krahasuar me numrin e tyre në njësitë administrative. Për rrjedhojë qyteti ka edhe numrin më të madh të fëmijëve që ndjekin kopshtet, duke bërë që përqendrimi më i madh i fëmijëve për institucion arsimor të jetë në qytet.

Aktualisht në bashkinë Elbasan funksionojnë 3 çerdhe (institucione të fëmijërisë së hershme), të cilat gjenden në lagjet: “Lagja e Re”, “Brigada 17 Sulmuese” dhe “Beqir Dardha”. Kapaciteti i fëmijëve që frekuentojnë çerdhet është 270 fëmijë (382 jane te regjistruar).

-Përshkrim i gjendjes infrastrukturore të institucioneve arsimore parashkollore dhe fëmijërisë së hershme.

Në nivel bashkie, gjendja infrastrukturore e institucioneve arsimore parashkollore që ndodhen në qytetin e Elbasanit dhe në 12 njësite administrative është relativisht e mirë, për faktin se gjatë gjithë vitit mirëmbahen me rikonstruksione të pjesshme dhe totale, sipas kërkesave të ardhura nga drejtoritë e kopshteve si dhe sipas identifikimit nga specialistët përkatës.

Përsa i përket infrastrukturës në këto objekte ka të domosdoshme ndërhyrje, sidomos në tualete dhe veçanërisht në shkollat ku janë vendosur grupe kopshti dhe klasa të arsimit parashkollor, pasi tualetet janë të përbashkëta me nxënësit e shkollave 9-vjecare dhe të mesme në njësitë administrative. Meqenëse kopshtet publike punojnë gjatë periudhës së verës, ku temperaturat janë të larta, nevojitet që në këto objekte të ketë sistem ftohjeje.

Kapaciteti akomodues i kopshteve të bashkisë së Elbasanit në total është për 3638 fëmijë. Pjesa më e madhe e kopshteve në bashki kanë kapacitete pritëse më të larta në raport me numrin e fëmijëve të regjistruar.

Në zona të caktuara të qytetit numri i popullsisë është i ndryshëm. Ka zona ku sipërfaqja më e madhe e tyre ka shtëpi banimi private (kryesisht zonat e vjetra të qytetit), ku dhe numri i

popullsisë është më i ulët, si rrjedhojë dhe numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht është më e ulët. Ka edhe zona të tjera ku mbizotërojnë pallatet (zonat ku qyteti është hapur dhe zgjeruar ndër vite) dhe numri i popullsisë është edhe më i lartë si rrjedhojë dhe numri i fëmijëve të regjistruar në këto kopshte është më i lartë. Për këtë arsye duhet parë mundësia e ndërtimit të godinave të reja në funksion të arsimit parashkollor, me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për përmirësimin e këtij shërbimi.

-Partenritetet dhe projektet në funksion dhe ndihmë të arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme.

Bashkia e Elbasanit është e fokusuar në krijimin dhe forcimin e partneriteteve të ndryshme për përthithjen e granteve nëpërmjet projekteve të aplikuara. Marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe koordinimi i punës me partnerë si: USAID, GIZ, Save the children, World Vision etj, do të jenë shtylla kryesore për realizimin e objektivave të parashtruara në këtë strategji, me qëllim përmirësimin e shërbimit në arsimin parashkollor dhe fëmijërinë e hershme. Për t'i ardhur në ndihmë të fëmijëve të arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme, bashkia e Elbasanit ka ofruar dhe ofron pagesën e shërbimit të çerdhes publike për fëmijet nga 0-3 vjeç të grave të dhunuara, që do të pajisen me urdhër mbrojtjeje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe fëmijëve që i përkasin shtresave vulnerabël.

8. Nevoja për ndërhyrje në bazë të situatës aktuale

Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës, logjistikës dhe cilësisë në institucionet e arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme vjen si rezultat i ndryshimeve të konsiderueshme demografike, ku zona të caktuara në qytet kanë densitet të popullsisë, ndërsa zonat informale kanë pësuar rënie të numrit të popullsisë. Në këto kushte, bashkia Elbasan sheh si të mundur ndërhyrjen për rikonceptimin e shërbimeve publike që ofron, sidomos në fushën e arsimit, që ka ndikim të drejtpërdrejtë në çdo familje të këtij qyteti.

Të dhënat statistikore reflektojnë numër të vogël fëmijësh, të cilët frekuentojnë çerdhet. Kjo do të thotë se vetëm 10% e fëmijëve që vijojnë më tej arsimin parashkollor, kanë qenë paraprakisht në institucione të fëmijërisë së hershme. Në planifikim të politikave dhe ndërhyrjeve lind nevoja për shtrirje më të gjerë të rrezes së shërbimit për edukimin në fëmijërinë e hershme.

Numri i nënave të papunësuar në këtë qytet është i evidentaur, duke shkaktuar dhe problematikë sociale dhe ekonomike. Krijimi i kushteve për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve do të kishte ndikim social, pasi krijohen kushtet për punësimin e nënave të reja, me qëllim që të mos jenë të angazhuara vetëm me mirërritjen e fëmijëve.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan ofron programin e studimit të karakterit profesional “Edukator 0-3 vjeç”. Kjo konsiderohet një mundësi shumë e mirë për të mundësuar hapjen e institucioneve të reja për fëmijërinë e hershme, duke qenë se në këtë qytet formohen nga ana profesionale individë të kualifikuar për të punuar me fëmijët e grupmoshës 0-3 vjeç.

Sipas ligjit 69/2018 (i ndryshuar) “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet statusi i grupeve të arsimit parashkollor që janë nën juridiksion të shkollave të arsimit parauniversitar, ku thuhet se: Neni.21. “Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyruar”. Kjo çështje është përcaktuar edhe në udhëzimin e MAS nr.14. dt.10.07.2023 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë”, ku përcaktohet se: “Klasat përgatitore funksionojnë në kopshte ose shkolla të arsimit bazë dhe frekuentohen nga nxënës 5 vjeç, që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor”. Në këto kushte kërkohet të rivlerësohet edhe njëherë statusi i fëmijëve që ndjekin arsimin e tyre pranë grupeve përgatitore në shkollat e arsimit bazë, nëse janë të këtij target-grupi (që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor). Identifikimi i numrit të fëmijëve që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin do të krijojë panoramën e qartë të numrit të nevojshëm të grupeve të klasave përgatitore që nevojiten. Ato mund të përcaktohen në vijim vetëm për disa institucione të arsimit parauniversitar në qytet, në varësi të kushteve të popullatës që ka nevojë për këtë shërbim. Për këtë arsye lind nevoja edhe për rikonceptim të organizimit të disa grupeve të arsimit parashkollor, të cilat janë në varësi të shkollave të arsimit parauniversitar. Ne mendojmë se grupimi i tyre me dejtori të veçantë do të kishtë më shumë efikasitet në përmirësimin e cilësisë së arsimit, por edhe në shërbimin që i ofrohet qytetarëve.

Nisur nga parashtrimi i situatës arsimore në bashkinë e Elbasanit lind nevoja për ndërhyrje në fushë të përmirësimit të infrastrukturës, ndërtimit të godinave të reja si institucione arsimore për

fëmijërinë e hershme dhe hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në këto institucione.

9. Politikat

A. Për përmirësimin e infrastrukturës:

Kushtet e mjediseve arsimore parashkollore dhe fëmijërisë së hershme, si dhe mjediseve rekreative në funksion të procesit mësimor dhe edukativ shfaqin një shkallë të kënaqshme mirëmbajtjeje, si pasojë e ndërhyrjeve periodike për rikonstrukcionin dhe mirëmbajtjen e tyre, ndërkohë që synojmë përmirësim të mëtejshëm.

Gjatë mandatit qeverisës të Kryetarit të Bashkisë Elbasan 2019-2023 u realizuan:

Godina arsimore të ndërtuara gjatë këtyre viteve:

Çerdhja nr.4

Kopshti publik nr.11

Godina arsimore të rikonstruara plotësisht, ku ofrohet arsim parashkollor:

Shkolla 9- vjeçare “Bardhyl Popa”.

Shkolla 9- vjeçare “Jorgji Dilo”.

Shkolla 9-vjeçare “Ali Agjahu”

Shkolla e mesme Artistike “Onufri”

Kënde sportive në mjediset e brendshme të IA, ku ofrohet arsim parashkollor:

Kopshti nr.5

Shkolla 9- vjeçare “Ali Agjahu”

Shkolla 9-vjeçare “Jorgji Dilo”

Shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri”

Shkolla 9-vjeçare “Qemal Haxhihasani”

Shkolla 9-vjeçare “Sulë Misiri”

Shkolla 9-vjeçare “Bardhyl Popa”

Shkolla e mesme e bashkuar “Luigj Gurakuqi”

Kënde sportive në mjediset e jashtme të IA, ku ofrohet arsim parashkollor:

Kopshti nr.9

Shkolla 9-vjeçare “Adem Krasniqi”

Shkolla 9-vjeçare “Abdyl Paralloi”

Shkolla e mesme Artistike “Onufri”

Kënde lojrash në mjediset e çerdheve dhe kopshteve publike:

Kopshti publik nr.2

Kopshti publik nr.5

Kopshti publik nr.7

Kopshti publik nr.9

Kopshti publik nr.11

Kopshti publik nr.12

Kopshti publik nr.17

Çerdhja publike nr.1

Çerdhja publike nr.2

Kapaciteti dhe gjendja e infrastrukturës arsimore parashkollore dhe fëmijërisë së hershme, menaxhimi dhe administrimi, vendndodhja e tyre gjeografikisht, numri i popullsisë dhe numri i fëmijëve për çdo institucion paraqesin karakteristika të ndryshme në zonën urbane dhe në atë rurale të bashkisë së Elbasanit. Gjithashtu, ka institucione parashkollore në qytet që kanë numër të lartë fëmijësh për grup, ndërsa institucione të tjera me numër tepër të reduktuar.

-Përmirësimi i infrastrukturës fillimisht, ku numri i fëmijëve është i reduktuar, do të sillte popullimin e tyre.

-Krijimi i mjediseve rekreative pranë këtyre kopshteve, minipalestrave, territoreve sportive apo kalimi i kopshteve me ushqim do të përmirësonte cilësinë e shërbimit të ofruar, përthithje më të lartë të numrit të fëmijëve dhe sigurinë e prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

-Ofrimi i shërbimeve shtesë, pas orarit të frekuentimit të kopshtit do të tërhiqte më shumë fëmijë në institucionet tona.

-Shtimi i institucioneve arsimore me ushqim, me qëllim ofrimin e një shërbimi kujdesues dhe mirërritës më të gjatë në aspektin kohor, pasi ofron lehtësira për rritjen e fëmijëve.

B. Për krijimin e institucioneve të reja:

Institucionet e fëmijërisë së hershme ndodhen vetëm në tri nga lagjet e qytetit të Elbasanit, duke bërë që të kemi fluks të regjistrimeve të fëmijëve në çerdhe. Njëkohësisht, pjesa më e madhe e qytetit është e pambuluar me shërbim për fëmijërinë e hershme. Në këto kushte lind nevoja për ngritjen dhe krijimin e institucioneve të reja të fëmijërisë së hershme, që mund të përcaktohen në lagjet që kanë numrin më të lartë të banorëve, si:

-lagjja “5 Maji” (zona rreth Teqes bektashiane), lagjja “11 Nëntori”, lagjja “Skënderbej”, “Kongresi i Elbasanit” (godina ish-drejtoria e ALUIZN-i) dhe lagjja “Vullnetari”.

Krijimi i mjedisve të reja të shihet si mundësi edhe për grupet e arsimit parashkollor që ndodhen në godinë të shkollave dhe jo më vete, si:

- “Abdyl Paralloi”, “Luigj Gurakuqi”, “Bardhul Popa”, “Fadil Gurmani”, “Naim Frashëri”, “Ali Agjah”, “Onufri”, “Jorgji Dilo”, “Xhaferr Hakani”, “Qemal Haxhihasani”, “Europa”, “Kuqan”, “Mengël”, “Hamit Mullisi”, “Ptoleme Xhuvani”, “Jeronim de Rada” etj.

Përqendrimi i grupeve në varësi të shkollave drejt kopshteve me drejtori më vete është i argumentuar sepse:

- sjell përshtatjen me kuadrin ligjor në fuqi,
- ekuilibron numrin e fëmijëve në kopshte,
- garanton për fëmijët formimin e karakterit brenda bashkësisë së bashkëmoshatarëve,
- krijon monitorim më të mirë dhe cilësor nga ana e drejtuesve të kopshteve dhe pushtetit lokal për cilësinë shërbimit arsimor që ofrohet,
- integron fëmijët me bashkëmoshatarët e tyre dhe jo në grupe të përziera,
- rrit cilësinë e shërbimit arsimor për fëmijët e kopshteve
- ul kostot shpenzuese për pushtetin lokal për mirëmbajtje

- ofron kushte më të mira për fëmijët krahasimisht me klasat në institucionet e arsimit parauniversitar,
- garanton performancën e çdo punonjësi në kushte të barabarta dhe me tregues të të matshëm.

C. Për politikat vendore:

Hartimi i politikave vendore dhe planifikimit për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor që ofrohet në institucionet e arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme do të fokusohet edhe në elemente të brendshëm të funksionimit të këtyre institucioneve. Për arsimin parashkollor, analiza e politikave dhe strategjive do të përqendrohet në tri lloje të proceseve organizative:

- procese të menaxhimit sektorial

Bashkia ka strukturë përgjegjëse të ngritur prej vitesh për mbulimin e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme. Ky sektor do të përmbushë detyrat e planifikimit afatgjatë dhe vjetor për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë që ofrohet në institucionet parashkollore. Për realizimin e këtyre proceseve kërkohen këto angazhime:

- përmbushja e procesit të regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore sipas vendbanimit;
- identifikimi i fëmijëve me nevojë për përfshirje;
- monitorimi i shërbimit të ofruar në institucionet e arsimit parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme;
- planifikimi për numrin e fëmijëve dhe stfit mësimor që nevojitet;
- planifikimi i përqendrimit të grupeve të kopshteve,
- krijimit të institucioneve të reja apo dhe mbylljen e institucioneve parashkollore me numër të pakët fëmijësh;
- monitorimi dhe vlerësimi i performancës për çdo punonjës të arsimit parashkollor e çerdhe (drejtues, mësues, edukatore dhe staf mbështetës);

- monitorim i frekuentimit të fëmijëve;
- mbështetje për punonjësit e arsimit parashkollor e fëmijërisë së hershme në funksion të zbatimit të kurrikulës;
- raportimi periodik për situatën në arsimin parashkollor e çerdhet;
- krijimi i databazës me të dhënat analitike për çdo kopësht, duke përfshirë të dhëna për fëmijët, punonjësit arsimorë dhe mbështetës në institucionet e arsimit parashkollor.

- procese të bashkëpunimit ndërsektorial

Në funksionet e veta detyruese, institucioni i bashkisë bashkëvepron proceset e punës me sektorët dhe drejtoritë që ka nën juridiksion, por edhe me institucione të tjera lokale e rajonale, me të cilat koordinon dhe bashkërendon punët për një efektivitete sa më të mirë. Në kuadër të bashkëpunimit ndërsektorial do të angazhohen të gjitha drejtoritë në varësi të bashkisë së Elbasanit, që lidhin detyrat e tyre në funksion të përmirësimit të cilësisë në shërbimin arsimor.

Proceset e punës do të konsistojnë në:

identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti; identifikimi i fëmijëve në situatë rruge; identifikimi i fëmijëve me AN; referimi i situatave të ndryshme që kërkojnë bashkëpunim të mëtejshëm; bashkëpunim dhe marrëdhënie koherente me MAS, ZVA, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Gjendja Civile, sektorë të ndryshëm brenda institucionit të bashkisë, universiteti “Aleksandër Xhuvani”, shoqata apo organizata joqeveritare që kanë në programin e tyre arsimin parashkollor dhe fëmijërinë e hershme; parashikimi i buxhetit për arsimin parashkollor e çerdhet; mirëmbajtja e infrastrukturës së godinave, dezinfektimi i mjediseve; përlllogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve, etj.

- politika të aspektit mbështetës

Bashkia e Elbasanit harton politika vendore dhe planifikime strategjike, të cilat kanë si qëllim përmirësimin e shërbimit arsimor parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme. Duke qenë se për arsimin parashkollor janë përcaktuar “Standardet e mësuesit të arsimit parashkollor” (ASCAP – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar) synohet qasja konceptuale e

institucioneve të varësisë të MAS për të mbështetur zhvillimin e përmirësimit të shërbimit arsimor. Në kuadrin e politikave mbështetëse bashkia Elbasan do të planifikojë:

1-Forcimin e zhvillimit profesional të punonjësve në arsimin parashkollor dhe të fëmijërisë së hershme përmes trajnimeve kualifikuese, sipas standardeve të përcaktuara nga ASCAP. Sipas Udhëzimit nr.16, dt. 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” njihet e drejta për të kryer trajnime nga subjekte që kanë në statutin e tyre si objekt zhvillimin e vazhduar profesional dhe trajnimin e punonjësve. Duke qenë se Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit në bashkinë e Elbasanit ka si funksion organizimin dhe realizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të personelit mësimdhënës të kopshteve që ka në varësi, atëherë krijohet mundësia që zhvillimi profesional të kryehet edhe nga vetë pushteti lokal. Në fokusin e trajnimeve do të jenë drejtuesit e institucioneve parashkollore për aspektet menaxhuese të institucionit dhe punonjësit arsimorë për përmirësimin dhe forcimin e standardeve të mësuesit të arsimit parashkollor. Bashkia e Elbasanit do të angazhojë për hartimin e materialeve trajnuese kapacitetet njerëzore më cilësore, duke kërkuar dhe bashkëpunimin me universitetin “Aleksandër Xhuvani” apo ZVA Elbasan, me qëllim trajnimin e vazhdueshëm. Trajnimet do të kenë në fokus:

-Zbatimi i Kodit të Etikës

- Bashkëpunimi me kolegët, familjarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit

- Pranimi dhe respektimi i diversitetit

- Mbrojtja fizike dhe shëndeti

- Mjedisi fizik

2-Krimin e mundësive për angazhimin e profesionit të Logopedit për të gjithë institucionet arsimore parashkollore, të cilët kanë fëmijë me spektrin e autizmit apo sindroma të tjera. Të dhënat për frekuentimin e kopshteve nga fëmijë me aftësi ndryshe na vendos përballë situatës për nevojën e një shërbimi të ri, siç është ai i logopedit, me qëllim mbështetjen e stafit mësimor dhe edukativ për punën që kryejnë dhe ofrimin e terapisë së të folurit ose terapi logopedike për këta fëmijë. Prania e shërbimit të logopedit do të identifikojë që në moshë të hershme fëmijët që kanë

probleme apo çrregullimet që lidhen komunikimin, me qëllim që të tilla raste të trajtohen në kohën e duhur. Ky shërbim mund të ofrohet si paketë lehtësuese për fëmijët me aftësi ndryshe.

3-Forcimin e organeve kolegjiale në institucionet e arsimit parashkollor, duke fuqizuar Bordin e Prindërve dhe Këshillin e Prindërve, me qëllim demokratizimin e vendimeve brenda institucionit. Institucionet arsimore kanë detyrimin ligjor (Ligji 69/2018 i ndryshuar) (Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”) të hartojnë planet afatmesme dhe planet vjetore të punës së tyre, ku përcaktohen dhe rubrikat e hartimit të këtij planifikimi. Nëpërmjet monitorimit të planifikimit të kryer, synohet rritja e kapaciteteve në lidhje me hartimin e planit afatmesëm dhe hartimi i planit në gjithë kopshtet e bashkisë Elbasan. Fuqizimi i rolit të Bordit dhe Këshillit të Prindërve do të ketë një rol kyç në menaxhimin e kopshtit, si dhe në mundësinë për të ofruar partnerë për bashkëpunim midis tyre dhe bashkisë Elbasan.

4. Forcimi i aspektit monitorues për detyrat funksionale që kryejnë drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor dhe punonjësit e stafit mësimor e mbështetës.

-Institucionet arsimore parashkollore nuk kanë ende një metodologji për të kryer vlerësimin e brendshëm të institucionit. Nëpërmjet metodologjisë së vlerësimit të brendshëm mundësohet përcaktimi i pikave të forta dhe pikave të dobëta të punës së institucionit. Vetëvlerësimi shërben si mjet për hartimin e një planifikimi cilësor dhe zbatimin e ligjshmërisë. Për këtë arsye bashkia Elbasan do të punojë nëpërmjet strukturave të saj për hartimin e një metodologjie vetëvlerësimi institucionale, e cila do të orientojë dhe do të drejtojë institucionet e arsimit parashkollor të kërkojnë ndryshime dhe zgjedhje për ofrimin e një shërbimi arsimor cilësor.

-Vlerësimi i performancës për çdo punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor do të konsistojë në hartimin e instrumenteve vlerësuese, të cilat do të realizohen nga sektori përgjegjës për arsimin në bashkinë Elbasan.

5. Bashkia Elbasan është e angazhuar për mbështetjen e fëmijëve me aftësi ndryshe, duke planifikuar procesin e identifikimit të tyre që në moshë të hershme. Edhe pse aktet ligjore në fuqi për arsimin parauniversitar përcaktojnë që vlerësimi i fëmijëve me aftësi ndryshe të realizohet nga Komisioni Multidisiplinar, i cili është nën kompetencën e ZVA-ve, kjo e drejtë nuk i jepet fëmijëve të institucioneve të arsimit parashkollor. Për procesin e vlerësimit ne do të kërkojmë

marrëveshje bashkëpunimi me MAS dhe MSH, me qëllim që Komisioni Multidisiplinar të ngrihet në nivel bashkie dhe të jetë nën kompetencën e pushtetit lokal, duke qenë se sektorë të veçantë në bashki dhe marrëveshjet institucionale me organizata jofitimprurëse në fushë të aftësisë ndryshe operojnë dhe punojnë prej vitesh. Identifikimi i aftësisë ndryshe dhe vlerësimi i fëmijëve në moshë të hershme mbron të drejtat e fëmijëve për të pasur mundësi të barabarta dhe për t'i njohur çdo fëmije të drejtën për t'u arsimuar dhe për t'i siguruar një sistem edukimi gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet.

10. Politikat e zhvillimit

Në programin politik të kryetarit të bashkisë së Elbasanit për mandatin qeverisës 2023-2027 është garantimi dhe përmirësimi i kushteve në institucionet e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme, duke investuar në përthithjen e numrit të fëmijëve që frekuentojnë këto institucione, pavarësisht zonës territoriale ku jetojnë, pasi investimi në arsim i vlen brezave të ardhshëm të këtij qyteti.

Politikat e zhvillimit që priten të realizohen:

-Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor, nëpërmjet veprimtarive të mirëplanifikuara në nivel të institucioneve të arsimit parashkollor dhe shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, me qëllim frekuentimin e arsimit parashkollor nga të gjithë fëmijët. Po ashtu, do të mbështeten aktivitetet e ndërgjegjësimit të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve lokalë.

-Avancimin e koordinimit ndërmjet pushtetit vendor dhe MAS për edukimin në fëmijërinë e hershme, bazuar në studime që do të realizohen nga pushteti lokal në bashkëpunim me partnerët, me qëllim avancimin e menaxhimit të këtij sektori.

-Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore. Përgjatë këtij mandati qeverisës do të krijohen kushtet që të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeç të kenë akses në arsimin parashkollor, qoftë nëpërmjet regjistrimit në grupet e 3-ta në kopshte, ose në klasa përgatitore.

-Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme.

-Inkurajimi dhe nxitja e hapjes së strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është argëtimi, loja, sporti etj

3. Përmirësimi i kushteve dhe standardeve të institucioneve arsimore parashkollore dhe të fëmijërisë së hershme nëpërmjet ndërtimit, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave të këtyre institucioneve, për zhvillimin e procesit edukativ dhe mirërritës në kushte të përshtatshme në të gjithë territorin administrativ të bashkisë Elbasan.

4. Përmirësimi i shërbimit dhe gjendjes fizike të institucioneve arsimore, me qëllim krijimin e kushteve për funksionimin dhe zhvillimin sa më normal të procesit edukues dhe arsimor.

5. Përmirësimi i kushteve me anë të sigurimit të bazës materiale dhe unifikimin e bazës didaktike për shërbimin arsimor parashkollor, me qëllim funksionimin sa më normal të objekteve shkollore. Rritja e sigurisë në ambientet arsimore parashkollore dhe krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët nëpërmjet shërbimit të rojeve të sigurisë publike dhe monitorimit me anë të sistemit të kamerave.

6. Përmirësimi i sistemeve të edukimit parashkollor e fëmijërisë së hershme, përmes zhvillimit profesional e trajnimit profesional, duke realizuar ndërlidhjen e politikës arsimore me politikat zhvillimore të bashkisë Elbasan.

7. Ngritja e Komisionit Multidisiplinar në nivel bashkie, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e fëmijëve me nevoja ndryshe që në moshë të hershme.

8. Krijimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me MAS për kryerjen e trajnimeve në kuadër të zhvillimit profesional për punonjësit e institucioneve arsimore parashkollore, me qëllim akreditimin e programeve/moduleve të trajnimit.

9. Planifikimi i paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë përfshirjeje, duke mundësuar lehtësira financiare për përballimin e frekuentimit në kopshtet me ushqim.

11. Plan për zbatimin e politikave dhe strategjisë vendore

Nr.	Politika	Objektivat	Veprimtaria	Përgjegjësi
A	Përmirësimi i infrastrukturës arsimore në institucionet e arsimit parashkollor dhe fëmijërisë së hershme	Rikonstruksion i mjediseve parashkollore dhe fëmijërisë së hershme	Planifikim për ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e institucioneve të arsimit parashkollor e fëmijërisë së hershme	
		Krijimi i mjediseve rekreative	Ndërtimi i palestrave, këndeve të lojrave, mjediseve çlodhëse etj.	
		Ofrimi i shërbimeve shtesë	Shfrytëzimi i mjediseve rekreative në funksion të komunitetit edhe pas përfundimit të orarit zyrtar.	
		Shtimi i institucioneve arsimore me ushqim	Krijimi i kushteve të përshtatshme në kopshtet pa ushqim për t'i kthyer në kopshte me ushqim	
B	Krijimi i institucioneve të reja	Ndërtimi dhe hapja e institucioneve të reja të fëmijërisë së hershme	Ndërtimi ose përshtatja e mjediseve egzistuese në varësi të Bashkisë Elbasan për hapjen e çerdheve	
		Përqendrimi i grupeve në varësi të shkollave drejt kopshteve me drejtori më vete	Planifikimi për procesin e përqendrimit dhe rivlerësimi i statusit të fëmijëve në grupet e klasave përgatitore	
		Krijimi i mjedisve të reja edhe për grupet e arsimit parashkollor në varësi të drejtorive të kopshteve, por në godinat shkollore	Riorganizimi i strukturave të arsimit parashkollor në drejtori më vete ose jo dhe minimizimi i grupeve të përziera	
C	Menaxhimi sektorial	Procesi i regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore sipas vendbanimit	Regjistrimi i fëmijëve sipas kapaciteteve akomoduese	
		Identifikimi i fëmijëve me nevojë për përfshirje dhe rritja e aksesit për përfshirje të të gjithë në kopsht	Fushatë sensibilizuese për familjet e fëmijëve që nuk frekuentojnë kopshtin	

		Përqendrimi i grupeve të kopshteve, krijimi i institucioneve të reja apo dhe mbyllja e institucioneve parashkollore pa numër fëmijësh	Planifikimi për përqendrimin e grupeve të kopshteve, hapjen apo mbylljen e institucioneve arsimore parashkollore.	
		Vlerësimi i performancës për çdo punonjës të arsimit parashkollor e çerdhe	Hartimi i instrumentit të vlerësimit të performancës për çdo punonjës të arsimit parashkollor	
		Raportimi periodik për situatën në arsimin parashkollor e çerdhet	Raportime, relacione, informacione periodike	
		Krijimi i databzës së të dhënave analitike për çdo fëmijë dhe punonjës të institucionit arsimor parashkollor e të fëmijërisë së hershme	Databazë e të dhënave analitike për fëmijët dhe kopshtin	
D	Bashkëpunimi ndërsektorial	Bashkëpunim koherent me MAS, ZVA, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Gjendja Civile, sektorë të ndryshëm brenda institucionit të bashkisë, universiteti “Aleksandër Xhuvani”, shoqata apo organizata joqeveritare	Koordinim i proceseve të punës në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit arsimor	
E	Aspekte mbështetëse	Forcimi i zhvillimit profesional të punonjësve në arsimin parashkollor	Trajnime profesionale dhe kualifikuese në kuadër të arritjes dhe fuqizimit të standardeve të mësuesit parashkollor	
		Punësimi dhe angazhimi i profesionit të Logopedit në institucionet arsimore parashkollore	Përfshirja e logopedëve në institucionet e arsimit parashkollor që kanë fëmijë me AN	
		Forcimin e organeve kolegiale në institucionet e arsimit parashkollor	Ngritja dhe funksionimi i organeve kolegiale në nivel institucioni të arsimit parashkollor, sipas ligjit 69/2012 (i ndryshuar) “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”	

		Forcimi i aspektit monitorues	Hartimi i platformave monitoruese dhe monitorimi i punës së institucioneve të arsimit parashkollor e fëmijërisë së hershme për vlerësimin e brendshëm të çdo institucioni në bashkëpunim me ZVA-në	
		Identifikimi i fëmijëve me aftësi ndryshe	Raport periodic nga institucionet e arsimit parashkollor për evidentimin dhe identifikimin e fëmijëve me AN që në moshë të hershme.	
F	Ngritja e komisionit Multidisiplinar në nivel bashkie	Vlerësimi i fëmijëve me AN nga Komisioni multidisiplinar që në fëmijërinë e hershme	Marrëveshje bashkëpunimi me MAS për ngritjen e Komisionit Multidisiplinar në nivel bashkie.	
G	Krijimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me MAS për kryerjen e trajnimeve në kuadër të zhvillimit profesional	Planifikimi, hartimi dhe realizimi i trajnimeve për zhvillim profesional sipas standardeve të mësuesit të arsimit parashkollor, në bashkëpunim me partnerët	Marrëveshje me MAS për akreditimin e programit të trajnimit për mësuesit e arsimit parashkollor në kuadër të zhvillimit profesional	
H	Planifikimi i paketave lehtësuese për fëmijët në nevojë që frekuentojnë kopshtet me ushqim	Zhvillimi i mundësive mbështetëse financiare në funksion të familjeve me të ardhura të pakta, të cilët duan të regjistrojnë fëmijët në kopshtet me ushqim	Hartimi i paketës lehtësuese për fëmijët në nevojë	

12. Analiza SWOT

<p>Përparësitë:</p> <p>Kuadri ligjor në funksion të politikave të hartuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” - VKM. Nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020” - Ligji 69/2018 (i ndryshuar) “Për arsimin 	<p>Dobësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Buxhete të kufizuara dhe të limituara - Nevojë për ndërhyrje në legjislacionin në fuqi, me qëllim adresimin e përgjegjësive më të qarta për pushtetin lokal në raport me arsimin parashkollor dhe fëmijërinë e
--	---

<p>parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2021-2026 - Udhëzimit nr.16, dt. 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” - “Standardet e mësuesit të arsimit parashkollor” - Projekti: Transparencë dhe barazi në ndërhyrjet infrastrukturore në shkolla mbështetur nga USAID dhe implementuar nga UNICEF, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Bashkinë Elbasan. 	<p>hershme</p> <ul style="list-style-type: none"> -Numër i lartë familjesh që jetojnë me ndihmë ekonomike dhe pamundësi për të përballuar shpenzimet e fëmijës në kopshte me drekë
<p>Mundësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shfrytëzimi i mjediseve dhe godinave në varësi të bashkisë Elbasan për ngritjen dhe krijimin e mjediseve të reja arsimore për parashkollorët dhe fëmijërinë e hershme - Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e godinave përmes planifikimit buxhetor të bashkisë e kryer në mënyrë periodike - Politika në funksion të përmirësimit për shërbimin e arsimit oparashkollor dhe fëmijërisë së hershme - Bashkëpunimi me institucione të qeverisë qendrore, OJF dhe organizata që kanë në fokusine punës së tyre arsimin 	<p>Rreziqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Perceptimi qytetar lidhur me strategjitë në funksion të përmirësimit të shërbimit në arsimin parashkollor dhe fëmijërinë e hershme - Shpërndarja e grupeve të kopshteve në zonat rurale, në largësi me njëri-tjetrin krijon vështirësi për monitorimin me efikasitet

Bashkia Elbasan

Maj, 2024